



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:041813

Datë: 17.05.2024

Numri i dokumentit: 05703171

C.nr.336/21

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Agron Karatash, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.Ç. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. D.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.....” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit 1,000.00 euro, jashtë seancës, me datë 17.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA

REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit R.Ç. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të “OBLIGOHET e paditura Kompania e Sigurimeve “E.....” me seli në Prishtinë, që paditësit t’ia kompensojë dëmin material në automjet në shumën prej 1,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditësh prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si dhe Obligohet e paditura Kompania e Sigurimeve “E.....” me seli në Prishtinë, që paditësit t’ia paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës në afat prej 15 ditësh prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarrim” **SI E PA BAZUAR.**

A r s y e t i m

Paditësi R.Ç. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij av. D.M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 04.03.2021, ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.....” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit 1,000.00 euro.

Në referatin e padisë ka theksuar se me datë 30.01.2021, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, ku deri tek aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve të vozitësit të automjetit A, i cili nuk respekton rregullat e komunikacionit dhe shkakton aksident me dëme materiale në automjetin B, të tipit “.....”, me targa të regjistrimit ngjyrë e kaltër, viti i prodhimit 2013. Më tej ka theksuar automjeti A si shkaktar i aksidentit në momentin e shkakimit të aksidentit

ka pasur të kontraktuar policën e sigurimit, andaj përgjegjësia bie mbi Kompaninë e Sigurimit “E.....”. Baza juridike e kërkesëpadisë nuk është kontestuese pasi që sipas policisë, aksidenti i komunikacionit është shkaktuar me lëshimet e drejtuesit të automjetit A dhe kjo duke u bazuar konform dispozitave ligjore të LMD-së dhe Ligjit të Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, paditësit i takon e drejta e kompensimit të dëmit nga ana e të paditurës, mbi bazën e lartcekurave i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e bazuar.

I autorizuari i paditësit av. D.M. me parashtrësën të cilën e ka dorëzuar në gjykatë me datë 15.05.2024, ka theksuar se përmes kësaj parashtrëse e informojnë gjykatën se pala nuk ka interes për vazhdimin e procedurës pasi që me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore dhe mbi këtë bazë në mungesë të interesit juridik për vazhdim të ndjekjes së çështjes përmes gjykatës e bëjnë heqjen dorë nga kërkesëpadia.

Gjykata, pas heqjes dorë nga kërkesëpadia nga ana e paditësit, konstatoi se kërkesat janë të disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 3 par. 2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së) ku përcaktohet se *“Palët mund të heqin dorë nga kërkesat e tyre, ta njohin kërkesën e palës kundërshtare si dhe të bëjnë ujdi (pajtim) gjyqësorë lidhur me kontestin e tyre”*, si dhe sipas nenit 149, par. 1 të LPK-së me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë)”*, andaj pa shqyrtim të mëtejshëm vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 3 par.3.2 dhe neni 149 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:041813, 17.05.2024

B.profesional
Ali Kosova

Gjyqtari
Agron Karatash

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181, paragrafit 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se heqja dorë nga kërkesëpadia është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.